

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 6510 Rep

Nr. 2231 Kol.



K O N T R A T E

SHIT - BLERJE TE PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE “IVA ELEKTRONIK” SH.P.K

Ne Tirane, sot me datën 02/12/2017, perpara meje noterit, Gjergj Kongoli, Anetar i Dhomes se Notereve Tirane ne seli ne adresen Rr.”Kont Urani” Nr. 3, paraqiten personalisht palet e meposhtme kontraktuese, te cilat kerkuan redaktimin e kesaj kontrate per shitjen e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise “**IVA ELEKTRONIK**” SH.P.K si me poshte:

SHITESI

Ilir Kumbaro, i biri i Skenderit, lindur me 02.03.1953 Bukuresht Rumani identifikuar me karte identiteti nr. 030627541 dhe numër personal F30302053R madhore me zotësi te plota juridike për te vepruar (zotërues i 51 kuotave te kapitalit)

Vladimir Pashaj, i biri i Samiut, lindur me 08.09.1949 ne Vlore dhe banues ne Tirane, identifikuar me karte identiteti nr. 024493283/E90908065P, madhor me zotësi te plota juridike për te vepruar, (zotërues i 49 kuotave te kapitalit)

*qe këtu e me poshtë ne këtë kontrate do te qubet “**SHITESIT**”*

ARTAN LEKA, i biri i Samiut,, lindur me 29.01.1956 ne Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga Bogdani, identifikuar me karte identiteti nr. 028912881/F60129050K, madhor dhe me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar

*qe këtu e me poshtë ne këtë kontrate do te qubet “**BLERESI**”*

OBJEKTI : Transferimi me ane te shitjes te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise “IVA ELEKTRONIK” Shkp:

- Transferimin me ane te shitjes se 17 kuotave te kapitalit te zotëruara nga ortaku Ilir Kumbaro ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.
- Transferimin me ane te shitjes se 16 kuotave te kapitalit te zotëruara nga ortaku Vladimir Pashaj ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.

BAZA LIGJORE ; Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqërisë “IVA ELEKTRONIK” SHPK, shoqëri e se drejtës shqiptare, e regjistruar me date 10.07.1996 e pajisur me Nipt **J61912013U**, me seli ne Tirane, Rruga e Barrikadave, Ku lla 8-te, Kati I, u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqërisë “**IVA**



ELEKTRONIK” Shpk, me pjesëmarrjen e Z. Ilir Kumbozo zotërues 51 kuotave te kapitalit dhe Z. Vladimir Pashaj, zotërues i 49 kuotave te kapitalit.

Ne baze te Vendimit te Asamblesë se Ortakeve u vendos:

- 1. Transferimin me ane te shitjes se 17 kuotave te kapitalit te zotëruara nga ortakut Ilir Kumbozo ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.*
- 2. Transferimin me ane te shitjes se 16 kuotave te kapitalit te zotëruara nga ortakut Vladimir Pashaj ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.*

Personat e mësipërm, pale ne këtë kontrate, janë paraqitur para meje noterit, dhe kërkuan te lidhin kontratën e shitjes me kushtet si me poshtë vijojnë:

1. Shitësi **Ilir Kumbozo**, zotëruese e 51 kuotave te kapitalit themeltar i transferon me ane te shitjes 17 kuotave te kapitalit me vlere nominale 17.000 Leke (shtatëmbëdhjetë mijë Leke) ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.
2. Shitësi Vladimir Pashaj, zotërues i 49 kuotave te kapitalit themeltar i transferon me ane te shitjes 16 kuota me vlere 16.000 Leke (gjashtëmbëdhjetë mijë Leke,, ne favor te ortakut te ri Z. Artan LEKA.
3. Blerësi Artan Leka, me nënshkrimin e kësaj kontrate, behet zotërues i 33 kuotave te shoqërisë “IVA ELEKTRONIK” Shpk, me vlere te përgjithshme 33.000 Leke (tridhjetë e tremijë Leke), vlere te cilen ia ka likuiduar ortakëve jashte zyres noteriale.
4. Shitësit **Z. Ilir Kumbozo dhe Z. Vladimir Pashaj**, sigurojne blerësin se pjesët e kapitalit themeltar, objekt i kësaj kontrate janë te lira nga çdo pretendim apo e drejte e personave te trete ne çastin e kalimit te pronësisë se tyre tek blerësi, por përgjigjet edhe nëse këto te meta shfaqen me pas.
5. Me nënshkrimin e kesaj kontrate, depozitim e saj dhe te akteve qe lidhen me kete transferim te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqërisë ne QKB, Shoqeri “IVA ELEKTRONIK” shpk perbehet nga ortakët:
 - **Z. Ilir Kumbozo, zotërues 34 kuotave te kapitalit, me vlere te përgjithshme 34.000 leke (tridhjetë e katërmijë Leke).**
 - **Z. Vladimir Pashaj, zotërues i 33 kuotave te kapitalit, me vlere te përgjithshme 33.000 leke (tridhjetë e tremijë Leke).**
 - **Z. Artan Leka, zotërues i 33,00 kuotave te kapitalit, me vlere te përgjithshme 33.000 leke (tridhjetë e tremije Leke).**
6. Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e saj nga palet, te cilat nuk mund te ndryshojne kushtet e vendosura ne te me pelqimin e tyre.
7. Çdo mosmarreveshje mes tyre palet angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.



8. Kjo kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne perputhje te plote me vullnetin e lire te paleve ne kater kopje te barasvlefshme. Palet marrin nga nje kopje, nje kopje mbetet ne zyren e noterit dhe kopja e katert do te depozitohet ne QKR.

9. Kontrata pasi u lexua nga une Noteri me ze te larte dhe te qarte, dispozitat e saj iu shjeguan paleve dhe ato pasi konfirmuan se kontrata eshte e perpiluar ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire e nenshkruan ate pa verejtje ne pranine time. Une noteri vertetoj vullnetin e paleve dhe kontraten sipas ligjit.

PER SHOQERINE "IVA ELEKTRONIK" SHPK

SHITESIT

VLADIMIR PASHAJ

Vladimir Pashaj
.....
Emer, mbiemer dhe firme

ILIR KUMBARO

Ilir Kumbaro
.....
Emer, mbiemer dhe firme

BLERESI

ARTAN LEKA

Artan Leka
.....
Emer, mbiemer dhe firme



NOTER

GJERGJ KONGOLI

Gjergj Kongoli
.....
REPUBLICA E SHQERISE
GJERGJ KONGOLI
NOTER
TIRANE